



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË PJESSHËM**  
**INSTITUCIONAL**

**Universiteti “Luarasi”**

Grupi i Ad Hoc:

1. Prof.As. Fatmir Guri

2. Prof.Dr. Thoma Korini

Tiranë, Nëntor 2020

## Hyrje

Kolegji Universitar Luarasi është liçensuar për ushtrimin e aktivitetit si shkollë e lartë universitare, jopublike, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë 11.09.2003 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Luarasi.”. Mbi këtë bazë ka filluar procesi i mësimdhënies në vitin akademik 2003-2004, fillimisht në degën drejtësi dhe lëshimin e diplomës “Jurist”.

Riorganizimi i shkollës së lartë universitare, jopublike “Luarasi” ka ndjekur ndryshimet në bazën ligjore dhe nënligjore për Arsimin e Lartë dhe në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është emërtur si Kolegji Universitar “Luarasi” duke integruar dy njësi kryesore: Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Drejtësisë.

Në vijim, me Urdhrin përkatës të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, në Kolegjin Universitar “Luarasi” është hapur njësi kryesore e tretë, *Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit*, duke i hapur rrugën plotësimit të kushteve për të përfutur statusin e Universitetit.

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 494, datë 11.10.2019, “Për riorganizimin institucional të Kolegjit Universitar “Luarasi” në Universitetin “Luarasi” është miratuar riorganizimi i institucionit në tre njësi kryesore, përkatësisht: *Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit* dhe është kërkuar që të ky institucion t’i nënshtrohet procesit të akreditimit.

Duhet theksuar se, Institucioni i Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar “Luarasi”, është akredituar me VBA Nr. 115, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite, me vlefshmëri deri më 14.12.2023, por ndryshimi i statusit kërkon rivlerësimin e pjesshëm institucional, gjë për të cilën Institucioni ka aplikuar pas miratimit të Statutit të ri me emërtimin Universiteti “Luarasi”, (Statut i cili është miratuar me UMASR Nr. 493 datë 11.10.2019).

Qëllimi i vlerësimit të pjesshëm institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle Universiteti “Luarasi” përmbush Standartet Shtetërore të Cilësisë.

Gjatë këtij procesi theksi është vënë në plotësimin e standarteve që lidhen me kalimin nga statusi i Kolegjit Universitar në atë të Universitetit. Në mënyrë të veçantë i është kushtuar vëmendje përmbushjes së standarteve lidhur me organizimin dhe menaxhimin e universitetit, ciklet e studimit, kërkimin shkencor dhe mbështetjen ndaj studentëve. Këto aspekte janë parë me përparësi për *Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit*.

Grupi *Ad hoc* i ngritur nga ASCAL zhvilloi vizitën pranë Universitetit “Luarasi” në datën 22.09.2020, duke realizuar gjithë takimet dhe vizitat e programuara me qëllim vlerësimin për përmbushjen e standarteve të cilësisë.

## I. Organizimi institucional dhe menaxhimi i Univeristetit “Luarasi”

Universiteti “Luarasi” (UL) ka përftuar statusin e Universitetit me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 494, datë 11.10.2019, “Për riorganizimin institucional të Kolegjit Universitar “Luarasi” në Universitetin “Luarasi”.

UL është organizuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kalimi në statusin e Universitetit u shoqërua me plotësimin e kërkesave përkatëse. Në këtë mënyrë, UL është riorganizuar dhe funksionon me strukturën në vijim:

- a) Fakulteti i Drejtësisë:
  - Departamenti i të drejtës Private;
  - Departamenti i të drejtës Publike;
  - Departamenti i të drejtës Penale.
- b) Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit
  - Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit;
  - Departamenti i Informatikës Ekonomike;
  - Departamenti i Matematikës dhe Statistikës.
- c) Fakulteti Ekonomik:
  - Departamenti Financë Bankë;
  - Departamenti Administrim Biznesi;
  - Departamenti Ekonomiks.

Duke ju referuar akreditimit institucional të Kolegjit Universitar “Luarasi” [Ev.: **Vendimi Nr.115, datë 15.12.2017 i Bordit të Akreditimit të ASCAL**] të cilit i korrespondonte struktura me dy fakultete, kalimi në statusin e Universitetit është shoqëruar me hapjen e *Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit (FTII)* si dhe të programeve të studimit që mbulohen nga njësitë bazë të këtij fakulteti. Struktura e këtij fakulteti, me tre Departamente, plotëson kërkesat minimale ligjore dhe garanton funksionimin në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

UL funksionon në bazë të Statutit, miratuar me Urdhër të MASR Nr. 493 datë 11.10.2019, i cili përbën bazën e veprimtarisë akademike të Universitetit [Ev.: **Statuti i UL**]. Bazuar në Statut janë hartuar rregulloret e brendshme [Ev.: **Rregullore e UL, Rregullore e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Rregullore e Këshillit Studentor, Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike**] të cilat rregullojnë funksionimin e UL në tërësi dhe atë të njësive përbërëse në veçanti. Statuti përcakton strukturën organizative të UL me njësitë kryesore si më poshtë:

- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti Ekonomik;
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.

Si organe drejtuese në Statut përcaktohen [Ev. **Statuti i UL**]:

Organet drejtuese akademike:

- Asambleja e Personelit Akademik;
- Senati akademik;

- Komisionet e përhershme;
- Rektorati
- Dekanatet;
- Këshilli i Etikës

Organi drejtues administrativ:

- Bordi i Administrimit

ndërsa si Autoritete drejtuese në Statut përcaktohen:

Autoritetet drejtuese akademike:

- Rektori;
- Dekanët e fakulteteve;
- Drejtuesit e departamenteve.

Autoritetet drejtuese administrative:

- Administratori i UL;
- Administratorët e fakulteteve.

Në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të UL janë përcaktuar qartë organizimi i institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, njërive kryesore dhe njërive bazë. Në këto dokumente janë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë specifike funksionet dhe veprimtaritë e secilit prej organeve drejtuese, organeve kolegiale dhe atyre administrative [Ev.: **RVB**].

Senati, Bordi i Administrimit dhe organet e tjera drejtuese të UL mbledhen në mënyrë periodike. UL ka hartuar procedura të qarta për organizimin e mbledhjeve, mbajtjen e proces-verbaleve, hartimin dhe bërjen të njohura të vendimeve përsa i përket Senatit dhe Bordit të Administrimit.

Trajtimi i problematikave dhe marrja e vendimeve për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe me aspekte të tjera të funksionimit të Universitetit ndjek një procedurë të qartë duke filluar me diskutim e vendimarrje në Departament e duke vazhduar deri në vendimarrjen përfundimtare në Senatin Akademik [Ev.: **Model Vendimarrjejenë Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit**].

Pjesëmarrja e studentëve në vendimarrje realizohet nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senatin Akademik [Ev.: **Statuti Universiteti Luarasi**] si dhe nëpërmjet marrjes në konsideratë të mendimeve të tyre nëpërmjet anketimeve të ndryshme të realizuara [Ev.: **Analiza e grup target-it të studentëve për cilësinë e programeve mësimore**]. Po ashtu në Rregulloren e Këshillit Studentor përcaktohet se komisionet e këtij këshilli propozojnë veprimtari, ligje për tu miratuar dhe ndryshime në statut ose rregullore [Ev.: **Rregullore e Këshillit Studentor**].

Seanti Akademik miraton Raportin vjetor të veprimtarisë së UL dhe krahas dërgimit në MASR e vë atë në dispozicion të personelit akademik, administrativ dhe të studentëve [Ev.: **Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019, Takime në UL**].

Në Statut përcaktohet se UL gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. UL e ushtron këtë autonomi në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi [Ev.: **Statuti UL, Procedura Staf Administrativ, Procedure Rekrutimi PAE, Procedure Rekrutimi PAK**].

Në përfundim, struktura organizative dhe menaxhimi i UL, garantojnë ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe kontribuojnë në zhvillimin e tij në përputhje me planin strategjik.

## **II. Burimet njerëzore, infrastrukurore dhe financiare**

### **Burimet Njerëzore**

UL ka të punësuar personel akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Duke ju referuar në mënyrë më të detajuar FTII [Ev.: **Struktura FTII, RVB**], departamentet përbërëse janë të plotësuar me stafin akademik si vijon [Ev.: **RVB, Stafi i FTII**]:

**Departamenti Teknologji Informacioni:** ka në përbërjen e tij 7 PAE, nga të cilët 2 me titull Prof.As., 1 me gradën shkencore Dr. dhe 4 Master i Shkencave, si dhe 8 PAK, nga të cilët 4 me titullin Prof.As., 2 me gradë shkencore Dr. dhe 2 Master i Shkencave.

**Departamenti Informatikë Ekonomike:** ka në përbërjen e tij 7 PAE, nga të cilët 1 me titull Prof., 2 me gradën shkencore Dr. dhe 4 Master i Shkencave, si dhe 2 PAK, nga të cilët 1 me titullin Prof. dhe 1 me gradë shkencore Dr..

**Departamenti Matematikë Statistikë:** ka në përbërjen e tij 7 PAE, nga të cilët 2 me titull Prof., 2 me gradën shkencore Dr. dhe 3 Master i Shkencave, si dhe 9 PAK, nga të cilët 1 me titullin Prof., 3 me titull Prof.As., 3 me gradë shkencore Dr. dhe 2 Master i Shkencave.

Në këtë mënyrë, të tre Departamentet e FTII plotësojnë kërkesat minimale ligjore të funksionimit të tyre si përsa i përket numrit ashtu edhe përsa i përket shkallës së kualifikimit.

Rekrutimi i personelit akademik dhe administrativ në UL, dhe në mënyrë të veçantë në FTII, kryhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Departamenti, pasi shqyrton nevojat për personel akademik, i paraqet kërkesën Dekanit të FTII shoqëruar me profilin e kandidatit të kërkuar si dhe kriteret që duhet të plotësojë. Në vijim, Dekani i paraqet kërkesën Rektorit të UL, i cili ngarkon Zyrën e Burimeve Njerëzore të UL për shpalljen e njoftimit për fillimin e procedurave të rekrutimit me specififikimet përkatëse. Vlerësimi i kandidaturave dhe shpallja e fituesit menaxhohet nga një komision *Ad hoc* i ngritur me urdhër të Dekanit të Fakultetit. Dekani i Fakultetit, pasi vlerëson procedurën e ndjekur nga Komisioni, i përcjell Rektorit fituesin e shpallur për vendin vakant me qëllim lidhjen e kontratës nëpërmjet Zyrës së Burimeve njerëzore. Këto procedura janë të mirëdokumentuara [Ev.: **Procedurë Rekrutimi PAE, Procedurë Rekrutimi PAK**].

FTII, si një fakultet i ri, ka mundësuar punësimin e një stafi akademik efektiv jo vetëm me kualifikimin e duhur, por edhe me një përkushtim ndaj institucionit, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor [Ev.: **Takim me stafin akademik**]. Në këtë drejtim kanë kontribuar edhe pagat konkurruese që aplikohen nga UL [Ev.: **Takim me Dekanin e FTII dhe Përgjegjësat e Departamenteve**]. Plotësimi të nevojave të mësimdhënies në FTII i shërben edhe një staf akademik cilësor me kontratë, me specialistë të spikatur në fushat përkatëse [Ev.: **Takim me Rektorin, Dekanin e FTII dhe Përgjegjësat e Departamenteve**]. Karakteristikat thellësisht aplikative të këtij fakulteti, kanë mundësuar kombinimin e formave të ndryshme të shpërbërimit të stafit me anë projektsh apo ndërtimit të aplikacioneve të ndryshme në ndihmë të UL apo të tretëve. Kjo është parë si një mënyrë për të tërhequr dhe siguruar vazhdimësinë e

punësimin të stafit në një sektor në të cilin konkurrenca është shumë e lartë. [Ev.: **Takim me Rektorin, Dekanin e FTII dhe Përgjegjësat e Departamenteve**].

UL ka bërë publike organigramën e tij [Ev.: <https://luarasi-univ.edu.al/rreth-nesh/organigrama-2/>] si dhe disponon një faqe WEB bashkëkohore me gjithë elementët e nevojshëm për të garantuar një informim të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të gjithë të të intersuarve për aktivitetin e UL. Në këtë mënyrë, me përditësimin e vazhdueshëm të kësaj faqeje, garantohej një shkallë e lartë transparence e funksionimit të institucionit edhe për publikun e gjerë duke ndihmuar edhe në orientimin e kandidatëve të mundshëm për ndjekjen e studimeve në këtë universitet.

### **Infrastruktura**

UL megjithëse nuk disponon pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, ka nënshkruar një kontratë qeraje e cila i garanton funksionimin deri në vitin 2033, në ambiente të rinovuara e moderne të cilat plotësojnë të gjitha kushtet teknike dhe ato higjieno-sanitare për ushtrimin e aktivitetit [Ev.: **RVB, Kontratë Qiraje Konvikti i Gjuhëve të Huaja, Planimetria godina, Vizita në institucion**].

FTII përdor për zhvillimin e mësimin në total 4 auditorë me sipërfaqe 266m<sup>2</sup>, numri i vendeve 50-90 dhe 3 laboratorë me sipërfaqe 225m<sup>2</sup>, numri i vendeve për sallë 60-90 [Ev.: **RVB, Vizita në institucion**].

Auditorët janë të pajisur me teknologji bashkëkohore për realizimin cilësor të mësimdhënies që përfshijnë kompjutera, videoprojektorë, lidhje interneti etj. [Ev.: **RVB, Vizita në institucion**].

UL disponon një sistem informacioni të avancuar i cili i shërben si personelit akademik ashtu edhe studentëve. Në mënyrë të veçantë ky sistem informacioni i kombinuar me platformën Moodle tregoi efikasitetin e tij gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 ku u kalua në zhvillimin e mësimin on-line [Ev.: **Takim me Rektorin**].

### **Burimet financiare**

UL përsa i takon financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare [Ev.: **RVB**]. Gjatë viteve të fundit të aktivitetit UL ka dëshmuar se ka kapacitetet e mjaftueshme për ruajtjen e gjendjes optimale financiare dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët [Ev.: **Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor**].

UL çdo vit, në mënyrë të rregullt, auditohej nga një ekspert kontabël i regjistruar. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit, vijnë nga tarifat e studimit që paguhen nga studentët. Për sa i përket kapaciteteve menaxhuese, Administratori i Institucionit dhe Zyra e Financës, në bashkëpunim me njëra-tjetrën, bashkërendojnë çështjet financiare dhe menaxhuese [Ev.: **Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor, RVB**].

Shpërndarja e burimeve financiare bëhet në mënyrë transparente, duke respektuar buxhetin vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit [Ev.: **RVB**]. Buxheti konsideron prioritetet e Kolegjit Universitar "Luarasi" dhe garanton financimin për zhvillimin me sukses të

programeve mësimore dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë [Ev.: **Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor**].

Projekt buxheti dikutohet në Rektorat, në Senat dhe më pas miratohet nga Bordi i Administrimit, në fillim të vitit akademik [Ev.: **RVB, Statuti i UL, Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019**].

Nga një shqyrtim i Raportit Vjetor të Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019 ku janë pasqyruar edhe elementë të planifikimit të buxhetit për vitin akademik 2019-2020, vërehet se ka një qëndrueshmëri financiare të institucionit me një rritje të ndjeshme të të ardhurave si dhe rritje të shpenzimeve duke parashikuar të tilla edhe në drejtim të përmirësimit të bazës laboratorike, kërkimit shkencor, pasurimit të bibliotekës si dhe të aktivizimit të ciklit të tretë të studimeve [Ev.: **Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019**].

### **III. Programet e studimit**

UL ofron programe studimi të nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave. Nga 18 programe studimi të ofruara, 14 prej tyre janë të akredituara ndërsa 4 janë në proces akreditimi [Ev.: **RVB**].

Programet e studimit që janë në proces akreditimi i përkasin FTII, dhe janë programe të reja studimi që janë licensuar në vitin 2018 [Ev.: **RVB, Takime në institucion**].

Programet e ofruara nga FTII janë programe të ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master):

#### Në ciklin e parë të studimeve:

- Bachelor në “*Informatikë Ekonomike*” me 180 kredite;
- Bachelor në “*Teknologji Informacioni dhe Inovacioni*” me 180 kredite.

#### Në ciklin e dytë të studimeve:

- Master Profesional në “*Siguria kibernetike dhe e informacioni*” me 60 kredite;
- Master i Shkencave në “*Teknologji informacioni dhe inovacioni*” me 120 kredite.

Programet e studimit të ofruara nga FTII janë në përputhje me misionin e UL [Ev: **Statuti Universiteti Luarasi**]. Programet e propozuara në këtë fakultet mbështeten në një studim të tregut të Arsimit të Lartë në Shqipëri [Ev.: **Raport Studim Tregu UL**]. E veçanta e këtij fakulteti ka të bëjë dhe me zhvillimin e një programi studimi Master Profesional në fushën e Sigurisë kibernetike dhe informacionit, duke synuar t’ju përgjigjen sfidave të zhvillimit aktual në këtë fushë si në botë e në mënyrë të veçantë edhe në Shqipëri [Ev.: **Takim me Rektorin e UL, Dekanin e FTII**]. Gjithashtu, komponentja e inovacionit në programet mësimore të ciklit të parë ashtu edhe në ato të ciklit të dytë, dëshmojnë për një veçanti të programeve të ofruara nga FTII dhe synojnë që t’ju përgjigjen më mirë nevojave të tregut [Ev.: **Takim me Dekanin dhe Përgj. e Departamenteve të FTII**]

Programet e studimeve shoqërohen me rregulloren përkatëse. Në rregullore përcaktohen një numër elementësh lidhur me funksionimin e programit të studimit si: objektivat formues specifike të programit, mundësitë punësimit, organizimi i programit të studimit (disiplinat

formuese), kriteret e pranimit, mënyra e organizimit të procesit mësimor, forma e studimeve, kërkesat për frekuentim, transferimi i studimeve etj. [Ev.: **Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike**]. Në rregulloret e Departamenteve të FTII përcaktohet edhe një numër elementësh që kanë të bëjnë me programet e studimeve të mbuluara nga departamenti përkatës si: mësimdhënia dhe kontrolli i dijeve, vlerësimi i dijeve të fituara nga studentët, parakushtet për hyrje në provim, diplomimi i studentëve etj. [Ev.: **Rregullorja e Departamentit të Informatikës Ekonomike**].

Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme Bachelor, Master dhe aktualisht është në studim aktivizimi i ciklit të tretë [Ev.: **Takime në institucion**]. Dhënia e diplomës shoqërohet me suplementin e diplomës [Ev.: **Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike**].

Miratimi i planeve mësimore të çdo programi studimi kalon nëpër një procedurë e cila fillon në Departament dhe mbyllet me miratimin në Senatin e UL. Kjo procedurë është transparente dhe e mirëdokumentuar [Ev.: **Model vendimarrje FTII**]. Planet mësimore publikohen në faqen zyrtare të UL [Ev.: **Model vendimarrje FTII**, <https://luarasi-univ.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit-dhe-inovacionit/> ]

Realizimi i programeve të studimit në FTII mbështetet nga një staf akademik efektiv dhe me kontratë cilësor dhe i motivuar [Ev.: **CV e personelit akademik, Takime në institucion**]. Ngarkesa mësimore e stafit akademik, në situatën aktuale, është në një nivel që mundëson zhvillimin cilësor të procesit mësimor dhe krijon hapësirë për angazhim në veprimtari kërkimore. Përgjithësisht personeli akademik angazhohet në maksimumi deri në 3 module dhe nuk kalohet norma vjetore e ngarkesës [Ev.: **Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019, Takime në UL**].

Zhvillimi i programeve të studimeve të ofruara nga FTII shoqërohet me komponentin e praktikës mësimore [Ev.: **Rregullore e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, Takime në institucion**]. Realizimi i praktikave bazohet në një program të detajuar të zhvillimit të tyre dhe vlerësimi i tyre bëhet me notë [Ev.: **Takime në institucion**]. Për realizimin e praktikave mësimore UL ka lidhur një numër marrëveshesh me institucione, kompani e subjekte të ndryshëm [Ev.: **Marrëveshje të lidhura nga UL, Takime në institucion**]. Për realizimin e praktikës mësimore pranë institucioneve të ndryshme angazhohet edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës [Ev.: **Takime në institucion**].

#### **IV. Studentët dhe mbështetja e tyre**

FTII, megjithëse ofron programe studimi të cilat janë në vitin e dytë të zhvillimit të tyre (liçensuar në vitin 2018), me ofertën akademike të propozuar ka mundur të ngjallë interes në rradhët e kandidatëve për studentë, duke arritur në një efektiv prej 202 studentësh për vitin akademik 2019-2020 [Ev.: **RVB**]. Nga studimi “*Universiteti “Luarasi” në tregun e Arsimit të Lartë në Shqipëri*”, rezulton se regjistrimet në *Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit* nga pikpamja numerike, për vitin akademik 2019-2020, zenë vendin e tretë në raport me 10 universitetet (apo shkollat e larta) jopublike që ofrojnë programe studimi të ngjajshme [Ev.: **Raport Studim Tregu UL, Takime në institucion**].

Pranimi i studentëve të rinj kryhet nëpërmjet procedurave transparente dhe mbi bazën e kriterëve të afishuara publikisht [Ev.: <https://luarasi-univ.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit-2017-2018/>].

UL mbështet studentët ekselentë duke ofruar bursa studimi të tilla si: Bursa të ekselencës (Bursa ekselence 1-vjeçare për maturantët dhe Bursa ekselence 1-vjeçare për studentët), Bursa Sociale, Bursa Liderशिpi, Bursa Promovimi, Bursa për transferimin e studimeve dhe Bursa Mbështetjeje. Për gjithë llojet e bursave egzistojnë procedura aplikimi dhe kriterë të përfundimit të përcaktuara qartë dhe të bëra publike [Ev.: **Rregullore për bursat studentore**, <https://luarasi-univ.edu.al/apliko-per-bursa/>, **Takime në institucion**]. Në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 UL ka mbështetur 157 studentë duke ju ofruar bursa studimi, ku 17 prej tyre janë nga FTII [Ev.: **RVB**].

Në UL funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës [Ev.: **Organigrama e UL**] e cila zhvillon aktivitetin bazuar në rregulloren përkatëse. Kjo zyrë ofron një gamë të gjerë shërbimesh për studentët dhe të diplomuarit e UL të cilat kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës [Ev.: **Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës**]. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës në UL, ndjek një sërë projektsh me interes si “Të njohim fakultetin”, “Klubi i debatit”, “Panairi virtual i punës”, “Dita e informimit”, “Të mbështesim moshat e treta”, “Klubi Ekonomistët e Rinj”, “Klubi i Vullnetarëve”, “Klubi Novus”, “Klubi Justicia”, “Klubi i Sportit” etj. [Ev.: <https://luarasi-univ.edu.al/zyra-e-keshillimit-te-karrieres/>, **Takime në institucion**].

Studentët e UL janë të organizuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet *Këshillit Studentor të UL*. Në këtë kuadër studentët zhvillojnë veprimtari të ndryshme, duke patur edhe mbështetjen financiare dhe logjistike të UL [Ev.: **RVB, Takime në institucion**]. Këshilli Studentor funksionon në bazë të Statutit dhe Rregullores së tij [Ev.: **Rregullore e Këshillit Studentor të UL**]. Studentët e UL mund të antarësohen në Klube Studentore [Ev.: **Formular për antarësimin e studentëve në klubet studentore**].

Studentët janë të përfaqësuar në Senatin akademik të UL duke transmetuar në të problematikave të tyre dhe duke u bërë pjesë e vendimarrjes [Ev.: **Statuti Universiteti Luarasi**]. Problematikat lidhur me jetën studentore vihen në evidencë edhe nëpërmjet pyetësorëve të ndryshëm të organizuar me ta si për cilësinë e mësimdhënies ashtu edhe për çështje të tjera. Së fundmi, nga ana e Zyrës së Nj.S.B.C. është organozuar edhe një anketim me qëllim vlerësimin e mësimin on-line [Ev.: **Takim me Zyrën e Nj.S.B.C.**].

Në UL ofrohet tutorati për studentët [Ev.: **RVB**]. Kjo mundësohet nëpërmjet angazhimit të pedagogëve të cilët presin studentët në orare të caktuara si dhe komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet postës elektronike në funksion të problematikave që hasen [Ev.: **Takim me pedagogët**].

Një komponente e rëndësishme e studimeve në FTII është dhe ajo e inkurajimit të punës në grup për studentët. Në lëndë të ndryshme (sidomos në ciklin e dytë të studimeve), propozohen projekte aplikative ku inkurajohet puna në grup [Ev.: **Takim me pedagogë të FTII**]. Gjithashtu, në programet e studimit Mashter i Shkencave inkurajohet aktivizimi i studentëve në kërkimin shkencor. Si shembull mund të përmendet krijimi i *Ekipit zhvillues të aplikacioneve*, ku janë angazhuar studentë të Masterit të Shkencave [Ev.: **Takime në institucion**].

Mobiliteti i studentëve në kuadër të projekteve europiane përbën një drejtim në fazën e eksplorimit për FTII. Në situatën aktuale ka marrëveshje të cilat pritet të konkretizohen. Ndërkohë ka patur aplikime për Erasmus+ dhe janë inicuar kontakte me 3 universitete të huaja për shkëmbime studentësh dhe stafi akademik [Ev.: **Takim me Dekanin dhe Përgj. e Departamenteve**].

Studentët e FTII kanë në dispozicion literaturën bazë dhe të rekomanduar në kuadër të programeve të studimit si dhe kanë akses në Bibliotekën e UL e cila ofron një numër të konsiderueshëm titujsh si dhe një akses në bibliotekat on-line [Ev. **RVB, Vizitë të institucion, Konfirmimi i RASH për bibliotekën on-line**].

Në UL ka procedura të miratuara për të trajtuar rastet e kopjimeve në provim, ankimimin e rezultateve të provimit, si dhe për trajtimin e konflikteve eventuale [Ev.: **Rregullore e UL, Takim me pedagogët**].

UL ofron lehtësi infrastrukturore për studentët me aftësi të kufizuara [Ev.: **Takim në Zyrën e Nj.S.B.C**].

Në shërbim të studentëve të FTII është dhe një sistem informacioni i avancuar si dhe faqja zyrtare ËEB e UL. Nëpërmjet faqes ËEB realizohet aksesimi në Portalin e Studentëve, i cili u siguron studentëve informacion të plotë në kohë reale për: profilin e studimeve, orarin mësimor, notat (rezultatet e studimeve), ecurinë e studimeve, njohjen me kurrikulën (programin mësimor), rregjistrimet për provimet e sezoneve përkatëse, kërkesë për diplomim/ç'rregjistrim/ transferim/ vërtetim notash/ vërtetim studenti, njoftime nga strukturat universitare akademike dhe administrative, etj. Nëpërmjet këtij portali studenti ka mundësinë të bëjë kërkesa online për informacion ndaj sekretarisë [Ev.: **Takime në institucion, <https://luarasi-univ.edu.al/shluj-luarasi/portali-studenteve/>**].

## V. Kërkimi Shkencor

Në aspektin cilësor kalimi në statusin e Universitetit shoqërohet me ofrimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë si dhe me zhvillimin e kërkimit shkencor bazë e të zbatuar. Për t'ju përgjigjur këtyre kërkesave UL ka hartuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2019-2024, në të cilën janë pasqyruar ambiciet e UL në drejtim të kthimit të institucionit në një qendër ekspertize në rrafshin kombëtar dhe atë ndërkombëtar [Ev.: **Strategjia e Kërkimit Shkencor 2019-2024, Takime në institucion**].

Strategjia e Kërkimit Shkencor kërkohet të detajohet në plan veprimi për çdo vit akademik [Ev.: **Planifikimi i Kërkimit Shkencor 2018-2019, 1019-2020**].

Kërkimi shkencor në UL zhvillohet në tre nivele: në nivel departamenti, i cili bëhet iniciator i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore, në nivel institucioni duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme, si dhe punë kërkimore individuale e pedagogëve [Ev.: **RVB, Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019**].

Në UL funksionon *Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë* e cila ka në strukturë dhe *Departamentin për Kërkim dhe Zhvillim Projektesh* i cili ka për qëllim lehtësimin e zhvillimit të projekteve, me qëllim përfshirjen e stafit akademik, kërkuesve dhe studentëve të UL në projekte për zhvillim kapacitetesh, kërkime shkencore dhe studime të ndryshme [Ev.: **RVB, <https://luarasi-univ.edu.al/zyra-e-projekteve-dhe-marredheniet-me-jashte/>**]

Në UL është aktive qendra FAB e cila është e fokusuar në e cila lehtëson zhvillimin e projekteve kërkimore me synim përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në projekte për zhvillim kapacitetesh, kërkime shkencore, studime të orientuara nga politikbërja dhe iniciativa të tjera që lidhen ngushtë me arsimin e lartë [Ev. **Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019, <https://luarasi-univ.edu.al/projektet/>**]

Në arritjen e objektivave në drejtim të kërkimit shkencor një rol të veçantë mendohet të luajë FTII [Ev.: **Takime në institucion**].

Ndër elementët të cilëve autoritetet drejtuese të UL dhe FTII dhe stafi akademik i FTII u kushtojnë një vëmendje të veçantë përmendim [Ev.: **Takime në institucion, RVB, Raport Vjetor i Veprimtarisë Mësimore-Kërkimore 2018-2019, Marrëveshje bashkëpunimi të FTII, Raport projektet 2019-2020**]:

- Identifikimin e fushave të kërkimit;
- Rritjen e fondeve për kërkimin shkencor;
- Inkurajimin dhe mbështetjen e stafit akademik të FTII për angazhimin në punë kërkimore si individualisht ashtu edhe në grup (në rang Departamenti ose edhe me gjerë);
- Bashkëpunimin me qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit;
- Zhvillimin e konferencave dhe pjesëmarrjen në veprimtari shkencore ;
- Ofrimin e lehtësirave të nevojshme për të kryer kërkime duke përfshirë literaturën, akses në internet, dhe mbështetje financiare për projektet konferenca dhe botimet e punës kërkimore;
- Mbështetjen e ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor;
- Rekrutimin e një stafi cilësor dhe me eksperiencë në drejtim të kërkimit shkencor;
- Kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik;
- Përfshirjen e studentëve, veçanërisht atyre të ciklit të dytë Master i Shkencave, në veprimtari kërkimore;
- Mbështetjen e pedagogëve të rinj (me MSc) në kryerjen e studimeve të doktoratës;
- Kryerjen e kontrollit antiplagjiaturë nëpërmjet një programi që mendohet të blihet në kuadër të Fondit të Ballkanit Perëndimor -WBF (Western Balkans Fund).

Programi i Studimeve Doktorale, si edhe programi Master Ekzekutiv si pjesë e ciklit të tretë të studimeve pritet që të nisë brenda periudhës 5-vjeçare në fushën e drejtësisë, ekonomisë

dhe teknologjisë së informacionit dhe inovacionit [Ev.: **Strategjia e Kërkimit Shkencor 2019-2024, Takime në institucion**].

### **Përfundime**

- UL është organizuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- FTII dhe departamentet përbërës plotësojnë kriteret ligjore si nga pikpamja numerike ashtu dhe përsa i përket kualifikimit;
- Struktura organizative dhe menaxhimi i UL, garantojnë ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe kontribuojnë në zhvillimin e tij në përputhje me planin strategjik;
- Burimet njerëzore, infrastrukurore dhe financiare të UL garantojnë zhvillimin perspektiv të institucionit në përputhje me vizionin e tij strategjik;
- Programet e studimit të ofruara nga FTII janë në përputhje me misionin e UL, pasqyrojnë kërkesat e tregut të punës, janë në përputhje me fushën e ekspertizës së Fakultetit, mbështeten në një studim të tregut të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe integrojnë drejtime specifike për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit në këtë fushë;
- Mbështetja e studentit realizohet nëpërmjet një numri mekanizmash efikase që përfshijnë informimin për programin përkatës të studimeve, procedurave transparente të pranimit, mbështetjes së studentëve ekselentë, mbështetjes logjistike e financiare të organizatave studentore për zhvillimin e aktiviteteve, pjesëmarrjen në vlerësimin e mësimdhënies dhe aspekteve të jetës së institucionit, pjesëmarrjen në vendimarrje, përgatitjen për tregun e punës, etj.;
- Kërkimi shkencor, megjithëse përbën një komponent të aktivitetit të UL me rritje të vazhdueshme, mbetet një sfidë për të ardhmen me qëllim realizimin e vizionit strategjik të UL. Mbështetja më e madhe financiare në këtë drejtim do të përkthehet në rezultate sinjifikative;
- Kompletimi i aktivitetit të institucionit me hapjen e ciklit të tretë do të plotësonte ofertën akademike, do të kontribonte në rritjen e aktivitetit kërkimor dhe do të poziciononte më mirë UL në raport me universitetet partnere dhe kërkesat e kohës;
- Rritja, tashmë e pranishme, e shkëmbimeve të studentëve dhe stafit akademik me universitete partnere jashtë vendit, do të kontribonte më mirë në ndërkombëtarizimin e aktivitetit të institucionit.